



e Rahovecit

*Komuna e Rahovecit nënshkruan memorandum bashkëpunimi me
DEMOS-in*

Komuna e Rahovecit, nënshkroi memorandum bashkëpunimi me DEMOS-in, për të forcuar transparencën buxhetore dhe përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen lokale.

Ky partneritet do të ndihmojë në planifikimin e hershëm buxhetor, konsultimet publike dhe përdorimin e platformave digjitale.



Mbahet seancë solemne për nder të 17-vjetorit të Republikës së Kosovës

Në vazhden e aktiviteteve të shumta për nder të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, përveç nderimeve pranë varreve të dëshmorëve, më 17 shkurt, u mbajt edhe seancë solemne për nder të kësaj dite.

Kryetari, në fjalimin e tij, theksoi rëndësinë që ka kjo ditë madhështore sot dhe rëndësinë që ka lufta e UÇK-së, e mbështetur nga aleatët tanë ndërkombëtarë.

